25. Procedura e ankesës 1. Cdo Operatori Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

-
3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti/enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti /enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenit 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1.....	14
<i>(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)</i>	14
FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE.....	14
Shtojca 2.....	16
<i>(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)</i>	16
LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT	16
FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS	17
Lista e Informacionit Konfidencial.....	18
Shtojca 6.....	20
Shtojca 7.....	21
[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor].....	21
FORMULARI I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT	21
Shtojca 8.....	33
<i>(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)</i>	34
FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT	34
I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik	34
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:	34
PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK.....	34
B: DEKLARATË	34
Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik	34
<i>(nëse është e zbatueshme)</i>	34
Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT	35
A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT.....	35
B: DEKLARATA.....	37
Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura.....	37
C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT.....	37
D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”.....	38
Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit	39
A: DEKLARATË.....	39
“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”	39
B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”	39

C: DEKLARATË	40
“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME	40
PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”	40
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vihen	40
ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte: 40	
D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera.....	41
<i>(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti /Enti kontraktor)</i>	44
PREVENTIVAT E PUNIMEVE.....	44
Shtojca 13.	48
<i>[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]</i>	49
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT	49
FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT	52
Shtojca 15.	54
FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT	55
Shtojca 22.	83
FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK	83
FORMULARI I PARAQITJES SË ARGUMENTAVE NGA OPERATORËT EKONOMIKË TE INTERESUAR PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK.....	87

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Vlerësimit;
 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 6. Preventivin e çmimeve
 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit /entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësinë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Bashkengjitur DST-se

Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 24 muaj

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3.Afati i realizimit</i>				
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas shtojcës 7 të këtyre dokumenteve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat

zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **506,693,978.6** (peseqind e gjashtëmilion e gjashtëqind e nentëdhjetë e tre mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e tete presje gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **2,026,775,914.48** (dy miliard e njetzet e gjashtëmilion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pese mijë e nentëqind e katermbëdhjetë presje dyzet e tete) lekë pa TVSH.
Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- 1.3** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

2.3.2 Licënsa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **NP-1 A** Punime gërmimi në tokë
- **NP-3 F** Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- **NP-7 B.** Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- **NP – 11 C** Ndertime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve, linje e TN e të mesme dhe shpërndarja e energjisë .
- **NP-12 B** Punime të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-2 B** Impiante hidro-termosantare dhe mirëmbajtja e tyre.
- **NS-3 B** Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- **N.S-4 C** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-12 B** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- **NS- 14 C** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- **NS – 18 A** Punime topogjeodezike
- **NS – 19 A** Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licensë leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per **3 (tre) muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.
- c) CV

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Topograf
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, të disponojnë si Staf mbështetës, (*jo domosdoshmërisht në licensën e shoqërisë*) të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse , CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Mekanik, i çertifikuar per sistemet e kondicionimit

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.7. Një punësim minimalisht prej **140** (njëqind e dyzet) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b.** Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për **3 muajt** e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	2 (dy)
- Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	2 (dy)
- Hidraulike	4 (kater)
- Elektracistë	4 (kater)
- Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm	1 (nje)
- Hekurkthyes	2 (dy)
- Karpentier	3 (tre)
- Hidroizolues	2 (dy)
- Muratorë/betonues	3 (tre)
- Suvatues	3 (tre)
- Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to	3 (tre)
- Punonjës duro-alumini	2 (dy)
- Bojaxhi	4 (kater)
- Specialiste për ngrohje/ftohje, kondicionim	2 (dy)
- Specialist gipsi	2 (dy)
- Eskavatorist/manovrator	2 (dy)
- Shofer për kamion	5 (pese)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.8/1 Për punonjesit eskavatorist/manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.9 Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë / dëshmi kualifikimi
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.10 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si: 1 (një) punonjes i pajisur me certifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.11 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (nje) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.12.Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Modeli	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
1	Gjenerator diesel S = 1000kVA / , Un =400V, komplet me kuadrin automatik dhe gjithcka te nevojshme sipas specifikimeve.		
2	U.P.S. 100 KVA, tension 3 fazor hyrje dhe 3 fazor dalje (per perdorim spitalor), (sipas specifikimeve teknike)		
3	U.P.S. 60 KVA, tension 3 fazor hyrje dhe 3 fazor dalje (per perdorim spitalor), (sipas specifikimeve teknike)		
4	Transformator fuqie T.M. S = 1600 KVA / 20/0.4 Kv, tip i I thate, me rezine, uk=6%, lidhje Dyn5, (sipas specifikimeve teknike)		
5	Transformator fuqie T.M. S = 1600 KVA / 20-6/0.4 Kv, tip i I thate, me rezine, uk=6%, lidhje Dyn5, (sipas specifikimeve teknike)		
6	Central telefonik PBX		
7	Regjistrues Digitale NVR 32 channel + Kompjuter me monitor bashke me licensa		
8	Kontroller Evakuimi Zanon+Licensa per tu instaluar tek Pc e sistemit te zjarrit		
9	Centrali i sinkronizimit te oreve komplet, ushqyes, interface FTP etj.		
10	AHU (Pajisje trajtimi ajri) No.6 : Urgjenca Kati 0 &-1 Prurja e ajrit dergim/kthim 12 200 / 13000 m ³ /h . Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 250/250 Pa. Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje DX coil 97.5kW / 100 kW Countinous heating .(ngrohje e vazhdueshme),Shkembyes nxehtyesiae me piastra me eficence 75%. Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 5.5kw/3 F400V/50Hz /kthim 4.00 kw 3 F/400V/50Hz. Kompletuar me inverter shpejtesie. Komplet filtrash G 4 e F8 ne dergim , G4 ne kthim , komplet kuader elektrik, set sensoresh, Ahu kit per lidhjen me sistemin VRF me Dx Coil , rregullator klimaterik te integrueshem me sistemin vrf , Struktura Alumini e panele te termoizoluar me panel 50 mm e tipit te jashtem.dhe silenciatore .		

	<p>Dimensionet AxBxH [mm]: 1570x5810x2760. Pesha 1552 kg.</p>		
11	<p>AHU (Pajisje trajtimi ajri) No.7 : Urgjenca Kati 1.1 Sallat kirurgjikale Higjenike me veshje te brendshme me inoks AISI 304 5/10 mm Prurja e ajrit dergim/kthim 20.000 / 19.600 m³/h . Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 500/250 Pa. Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje DX coil kW171 / 212 kW, Countinous heating . (ngrohje e vazhdueshme),Avullues 6-60 kg/h per rregullimin e lageshtise .Shkembyes nxehtyesiae me piastra me eficence 75%. Bateri me uje per pasngrohje 171kw 45/40grade Celsius Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 11kw/3 F400V/50Hz /kthim 11 kw 3 F/400V/50Hz. Kompletuar me inverter shpejtesie. Komplet filtrash G 4 e F8 ne dergim Llama Germicide UV per sterilizim , F8 Filtra ne kthim , komplet kuader elektrik, set sensoresh ,danpera , valvol 3 rrugeshe e te gjitha aksesoret e automatizimit Ahu kit per lidhjen me sistemin VRF me Dx Coil , rregullator klimaterik te integrueshem me sistemin vrf , Struktura Alumini e panele te termoizoluar me panel 50 mm e tipit te jashtem.dhe silenciatore . Dimensionet AxBxH [mm]: 2070x9700x3160 mm. Pesha 3430 kg.</p>		
12	<p>AHU (Pajisje trajtimi ajri) No 8 : Urgjenca Kati 1 Sallat kirurgjikale Higjenike me veshje te brendshme me inoks AISI 304 5/10 mm Prurja e ajrit dergim/kthim 15.500 / 15.000 m³/h . Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 500/250 Pa. Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje DX coil kW132 / 160 kW,Countinous heating .(ngrohje e vazhdueshme)Avullues 6-60 kg/h per rregullimin e lageshtise . Bateri me uje per pasngrohje 132kw ,45/40grade Celsius Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 7.5kw/3 F400V/50Hz /kthim 5.5 kw 3 F/400V/50Hz. Kompletuar me inverter shpejtesie. Komplet filtrash G 4 e F8 ne dergim Llama Germicide UV per sterilizim , F8 Filtra ne kthim , komplet kuader elektrik,anpera , valvol 3 rrugeshe e te gjitha aksesoret e automatizimit set sensoresh, Ahu kit per lidhjen me sistemin VRF me Dx Coil ,</p>		

	<p>rregullator klimaterik te integrueshem me sistemin vrf , Struktura Alumini e panele te termoizoluar me panel 50 mm e tipit te jashtem.dhe silenciatore .</p> <p>Dimensionet AxBxH [mm]: 1770x9200x2960.</p> <p>Pesha 2756 kg.</p>		
13	<p>AHU (Pajisje trajtimi ajri) No 9 : Urgjenca Kati 0 Sallat kirurgjikale</p> <p>Higjenike me veshje te brendshme me inoks AISI 304 5/10 mm Prurja e ajrit dergim/kthim 12.500 / 12.000 m³/h .</p> <p>Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 500/250 Pa.</p> <p>Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje DX coil kW110 / 137 kW,Countinuous heating .(ngrohje e vazhdueshme)Avullues 6-60 kg/h per rregullimin e lageshtise .Shkembyes nxehtyesiae me piastra me eficense 75%.</p> <p>Bateri me uje per pasngrohje 110 kw ,45/40grade Celsius Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 7.5kw/3 F400V/50Hz /kthim 5 kw 3 F/400V/50Hz.</p> <p>Kompletuar me inverter shpejtesie. Komplet filtrash G 4 e F8 ne dergim Lampa Germicide UV per sterilizim , F8 Filtra ne kthim , komplet kuader elektrik, set sensoresh, anpera , valvol 3 rrugeshe e te gjitha aksesoret e automatizimitAhu kit per lidhjen me sistemin VRF me Dx Coil ,</p> <p>rregullator klimaterik te integrueshem me sistemin vrf , Struktura Alumini e panele te termoizoluar me panel 50 mm e tipit te jashtem.dhe silenciatore .</p> <p>Dimensionet AxBxH [mm]: 1570x7760x2760.</p> <p>Pesha 1856 kg.</p>		
14	<p>Pompe nxehtesie VRF me kondensim me ajer , Modulare me kompresor inverter tip "scroll" me freon R410A per sisteme aplikimi VRF me ngrohje te vazhdueshme, me kontroll te temperatures se freonit ne dalje, me kapacitet termik ne ftohje 137 kw, kapacitet termik ne ngrohje 110 kw</p>		
15	<p>Pompe nxehtesie VRF me kondensim me ajer , Modulare me kompresor inverter tip "scroll" me freon R410A per sisteme aplikimi VRF me ngrohje te vazhdueshme, me kontroll te temperatures se freonit ne dalje, me kapacitet termik ne ftohje 150 kw, kapacitet termik ne ngrohje 139 kw</p>		
16	<p>Pompe nxehtesie VRF me kondensim me ajer , Modulare me kompresor inverter tip "scroll" me freon R410A per sisteme aplikimi VRF me ngrohje te vazhdueshme, me kontroll te temperatures se freonit ne dalje, me kapacitet termik ne ftohje 212 kw, kapacitet termik ne ngrohje 177 kw.</p>		

17	<p>Pompe Nxehtesie Ajër -Ujë Nr 1 & 2 :</p> <p>Baterite pasngrohese AHU-te Urgjenca Kati 1& 2 Sallat kirurgjikale te kompletuara me kit hidronik qark primar me akumul 500 litra dhe qark sekondar me pompe qarkulluese me prurje 33.5 m³ /h, dhe lartesi manometrike 12 mH₂O njera ne pune dhe tjetra rezerve ,antivibrant ne lidhjen e tubacioneve , plotesues automatik , enezgjirimi , valvol sigurie , filter uji , kondra valvola , saracineska , termometra e manometra .susta antivibruse e te gjithë aksesoret e nevojshem per montim .</p> <p>Dimensionet AxBxH [mm]: 5025x1097x1805 mm. Pesha 1564 kg.</p>		
18	<p>Ashensor per paciente me 3 ndalesa, shpejtesi 1m/s, fuqia 9.2 kW, kabina 240x140cm me veshje inoksi, me ndricues tip spot, dysHEME graniti dhe me ventilim te brendshem</p>		

- Tabela është e detyrueshme për tu plotësuar për të gjithë artikujt e listuar. Mosplotësimi i kësaj tabele është kusht skualifikues.

2.3.12/a Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.12, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara.

2.3.12/b Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha pajisjet sipas pikës 2.3.12. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

2.3.12 OE të paraqesë një deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 24 (njëzetë e katër) muaj kalendarike.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN **ISO 9001-2015 e perditesuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN **ISO 14001-2015 e perditesuar** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- c) Certifikatën SSH **ISO 45001:2018 e perditesuar** (SSH EN **ISO 45001 -2023**) (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqese ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marre persiper të realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.15 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	copë	4	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Kamion me kapacitet mbajtes deri 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Shtuese asfalti	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Rrul	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Gjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Depozite uji deri ne 5000 litra	copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Kontenier ndërtimi stacionar (zyrë)	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Pompe Suvatimi	copë	2	Në pronësi ose me qera
14	Makineri per prerje hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Makineri per kthim hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Elektrosaldatrice	copë	2	Në pronësi ose me qera
17	Vibrator	copë	2	Në pronësi ose me qera
18	Matrapik	copë	4	Në pronësi ose me qera
19	Trapan	copë	4	Në pronësi ose me qera
20	Paisje niveluese për nivelim shtresash	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Pompë uji	copë	2	Në pronësi ose me qera

22	Betoniere me kapacitet mbi 0.3 m3	copë	5	Në pronësi ose me qera
23	Skela metalike	m2	1000 m ²	Në pronësi ose me qera

Pajisje te sigurisë ne kantier:

Kokore	në pronësi ose me qera	120	cope
Jelek	në pronësi ose me qera	120	cope
Tabela Sigurimi Teknik	në pronësi ose me qera	35	cope
Fikse Zjarri	në pronësi ose me qera	7	cope
Kuti Ndihme e shpejte	në pronësi ose me qera	15	cope
Prozhektor ndriçimi naten	në pronësi ose me qera	4	cope

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- a.** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b.** Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- c.** Për mjetet që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik

_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
<ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik			
